


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE DURRES  
NOTERE  
Albana H. Hoti  
Tel.Fax ±35552221139  
hoti\_albana@hotmail.com



Nr. 232 Rep.

Nr. 113/1 Kol.

## KONTRATË

### SHIT – BLERJE KUOTASH

Sot ne Durres me date 03 te muajit Shkurt 2014 (dymije e trembedhete), ditën e hete, perpara meje noterit Albana H. Hoti, anetar i dhomes Notereve Durres, me NIPT K31601507J dhe liçence profesionale nr.235, me adrese L.4 Rr."Egnatia" 405 Durres, u paraqiten personalisht palet e meposhtme, të cilët më kërkuan redaktimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuotash me termat e mëposhtme:

**SHITËSI:** Znj.MIA ALBERT MUÇA lindur ne Elbasan me 06.07.1974, bnauese ne Tirane, Rruga Dervish Hima, shtetase shqiptare, madhore me zotesi te plote per te vepruar, mbajtese e Pasaportes me nr.BC8441293/H457061290., me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise **DEUTSCHCOLOR SHPK**, rregjistruar si person juridik me date 26.01.2012 prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NIPT L21326504J, me seli ne Durres Autostrada Tirane-Durres, me objekt import eksport, tregtim llacrash etj, me status aktiv.

**BLERËSI:** Z.LUAN SHAHIN MUÇA, lindur ne Skenderbej Elbasan me 05.08.1971, banues Tirane Rr.Sheh Ahmet Pazari, shtetas shqiptar, madhor me zotesi te plote per te vepruar, mbajttesi i Pasaportes me nr.BE0431405/H10805062A.

**OBJEKTI:**Shitja e kuotave të shoqërisë "DEUTSCHCOLOR" shpk në masën 50% të kapitalit themeltar kuota këto që zotërohen nga ortakja e shoqërisë Znj.Mia Muça, me cilësinë e shitëses dhe blerja e tyre nga Z.Luan Muça, me cilësinë e blerësit.

### PËRMBAJTA E KONTRATËS

Shoqëria "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. është regjistruar pranë QKR sipas Ekstraktit Historik te Regjistrimit i dates 23.01.2014 me nr. NIPT L21326504J.

Me vendimin e datës 30.01.2014 të Asamblese se ortakeve të shoqërisë, është vendosur shitja e kuotave në masën 50% të tyre nga ana e ortakës të shoqërisë Znj.Mia Muça dhe blerja nga ana e Z.Luan Muça në masën 50%, duke u bere ky i fundit zoterues i 50 % te kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. me Znj.Mia Muça.

Shitja e masës prej 50% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. sjell humbjen e të drejtës së pronësisë në masën 50% mbi kuotat e kapitalit themeltar të ortakës së shoqërisë Znj.Mia Muça, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e mësipërm të Ortakeve te kesaj shoqerie me datë 30.01.2014

Handwritten signature of Znj. Mia Muça.

Handwritten signature of Z. Luan Shahin Muça.

Shitësja Znj.Mia Muça, është plotësisht dakord të shesë me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë 50% të kuotave që ajo zotëron në shoqërinë "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. Kjo shitje kuotash, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit Z.Luan Muça ku përfiton dhe zotërimin e 50% të kuotave nga kjo blerje, duke u bere Ortak me Znj.Mia Muça zoterues i 50% te kuotave te kapitalit themeltar.

Blerësi, Z.Luan Muça, është plotësisht dakord që të blej me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, masën prej 50% të kuotave të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k.

#### MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË KUOTAVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitësja Znj.Mia Muça ortak i shoqërisë humbet pronësinë e kuotave ne masen 50 % të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. ndërsa blerësi Z.Luan Muça, bëhen pronar i 50% të kuotave të shitura, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që mbart blerja e këtyre kuotave.

Shoqëria Tregtare "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k., pas realizimit të këtij operacioni shit-blerje kuotash, sipas kësaj kontrate, do të ketë si ortak te saj Z.Luan Muça i cili zotëron keshtu 50% te kapitalit themeltar dhe Znj.Mia Muça zoterues i 50% te kuotave te kapitalit themeltar.

#### ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje kuotash të shoqërisë "DEUTSCHCOLOR" Sh.p.k. do të jetë shuma prej 50'000 lek, çmim i cili perfaqeson vleren e totale te kuotave qe shiten.

#### DISPOZITA TË FUNDIT

Kontrata hartohet në gjashtë kopje të njëjta nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë dhe një kopje pranë Zyrës së Noterisë ku ajo u redaktua.

Termat e kësaj kontrate, pasi u redaktuan prej meje Noterit, iu bënë të njohura palëve kontraktuese, të cilat e nënshkruan atë me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në praninë time.

#### PALËT

SHITËSI

*Mia Muça*



BLERËSI

*Luan Muça*

NOTERE

*Alban...*